



Prishtinë: 11.11.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_301\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_R\_466\_10\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 14.6 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_R\_466\_10\_10**;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 11 nëntor 2010 nxori këtë:**

### VENDIM

**PRANOHET** ankesa e konsumatorit Hasan Grajqevci (shifra e konsumatorit DPR – 90028668), nga Prishtina si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e të këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 26.02.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 19.02.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 22.06.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë ndërruar njehsorin elektrik, ku kanë hequr njehsorin elektrik nr. 32807903 dhe kanë vendosur njehsorin elektrik nr. 4693004.  
**Provë:** Vërtetimi mbi heqjen dhe ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 004838 të datës 02.06.2008
- Me datë 14.08.2008 punëtorët e qendrës së kalibrimit në KEK kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 32807903, ku kanë konstatuar se njehsori elektrik vulat shtetërore i ka në falsifikuar, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, numëruesi i manipuluar.  
**Provë:** Procesverbali i qendrës së kalibrimit në KEK nr. 7/9 të datës 09.09.2008
- Me datë 29.10.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.  
**Provë:** Procesverbali nr. 234296 të datës 29.10.2008
-

- Me datë 14.11.2008 KEK-u e ngarkon konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR8HP06819 në vlerë prej 3,684.88 €.  
**Provë:** Fatura e KEK-ut DPR8HP06819 e datës 14.11.2008
- Me datë 27.01.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 19.02.2009 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatori duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e qendrës së kalibrimin dhe procesverbalin e kontrollës.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 19.02.2009
- Me datë 26.02.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 08.12.2009 DMK në pajtim me paragrafin 14.3 të nenit 14 të Rregullit mbi Procedurën për Zgjidhjen e Kontesteve në Sektorin e Energjisë, ka analizuar ankesat e konsumatorëve dhe ka vlerësuar se zyrtarët e autorizuar për inspektimin e pikave matëse gjatë përpilimit të procesverbaleve nuk kanë shënuar shumat e fuqive të shpenzuesve të inventarizuara me rastin e inspektimit të pikave matëse tek konsumatorët komercial dhe industrial ka kthyer në rishqyrtim lëndën e konsumatorit. Sipas kësaj KEK-u ka vepruar në kundërshtim me Nenin 12 të Procedurës së Përkohshme për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të Paautorizuar.  
**Provë:** Shkresa e DMK-së dërguar KEK-ut (Departamentit për Konsumator) për rishqyrtimin e ankesave të konsumatorëve
- Me datë 21.05.2010 Komisioni i KEK-ut në përbërje të stafit përgjegjës të operatorit të rrjetit dhe furnizuesit publik, ka refuzuar prapë ankesën e konsumatorit.  
**Provë:** Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për kontrollimin e njehsorëve elektrik në laboratorin e qendrës së kalibrimin kanë konstatuar se njehsori elektrik nr. 32807903, vulat shtetërore i ka në falsifikuara, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, numëruesi i manipuluar, ky konstatim është bërë pa pjesëmarrjen e palës së tretë (përfaqësuesve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë apo përfaqësuesve të institucioneve të pavarura) ashtu siç është përcaktuar në nenin 7 të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar
- ✓ Pasi që DMK e ka dërguar lëndën e konsumatorit në rishqyrtim në KEK, punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me datë 08.03.2010 dhe me date 18.03.2010 kanë bërë regjistrimin e pajisjeve elektrike.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 190679 të datës 08.03.2010 dhe nr. 190693 të datës 18.03.2010

- ✓ KEK-u pasi ka marrë pajisjet elektrike të regjistruara në procesverbalin nr. 190679 të datës 08.03.2010 dhe nr. 190693 të datës 18.03.2010 ka bërë edhe llogaritjen e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Sipas llogaritjeve të bëra nga KEK-u del se konsumatori është dashur të faturohet me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike në vlerë negative prej 1,573.4 €.  
**Provë:** Llogaritje e KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar
- ✓ Komisioni i KEK-ut pasi ka marrë lëndën e konsumatorit në rishqyrtim, ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: *“konsumatorit njehsori nr. 32807903 sipas procesverbalit nr. 004838 i është ndërruar me dt. 02.06.2008. Ky njehsor është dërguar në shërbimin e kalibrimin dhe me dt. 09.09.2008 është përgatitur procesverbali i kontrollimit detal nr. 7/9 sipas të cilit: njehsori pllombat shtetërore i ka të falsifikuara, nga ana e jashtme dëmtime tjera nuk ka, në të dy anët e pllombës, kapaku i epërm është i thyer, numëruesi i manipuluar, ka gjurmë të kthimit mbrapa të numrave në numëror. Në bazë të këtij procesverbali shërbimi i faturimit ka llogaritur faturën interne duke u bazuar në siguresa 20 A. Sipas kësaj edhe me dt. 14.11.2008 ka rezultuar fatura e RH në vlerë 3,684.88 €. Vërejtje: Fatura interne në bazë të cilit llogaritet fatura e RH, sipas Proc. Perk. Për idenë. Dhe paran. Duhet të bazohet në pajisjet të pajisjet të cilat i furnizon pika matëse e jo në siguresa siç është llogaritur RH. Njehsori është prodhim i viti 2002. Shpenzimi mesatar i energjisë që është regjistruar në periudhën e RH është 913 KW, në periudhën para RH është 1259 kWh dhe pas RH është 469 kW. Rillogaritja e RH me pajisje sipas procesverbalit të kontrollës rezulton me vlerë negative 1,573.40 €. Vendimi i komisionit: Dënimi meritot”.*  
**Provë:** Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 05.05.2010
- ✓ Komisioni i KEK-ut në vendimin e tyre pas rishqyrtimit të lëndës së konsumatorit ka refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se: në bazë të fakteve nga procesverbali nr. 7/9 dt. 09.09.2008 dhe sipas parametrave të paraqitura në procesverbalin nr. 234296 dt. 29.10.2008 konstatojmë se fatura nr. DPR08HP06819 dt. 14.11.2008 në vlerë 3,684.88€ është llogaritur konform nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Këtë arsyetim e konfirmon edhe fakti se shpenzimi mesatar i energjisë së regjistruar në periudhën e keqpërdorimit është më i vogël (913 KWh) se në periudhën para keqpërdorimit (1259 KWh). Rillogaritja e RH sipas pajisjeve nga procesverbali nr. 190693 dt. 18.03.2010 rezulton në vlerë negative -1,573.40 €. Por pasi evidentimi i këtyre pajisjeve është bërë në një periudhë tjetër nga periudha e rikthimit të humbjeve, komisioni qëndron pranë vendimit ekzistues.  
**Provë:** Vendimi i Komisionit të KEK-ut të datës 21.05.2010
- ✓ KEK-u edhe përkundër asaj që DMK ka kthyer në rishqyrtim ankesën e konsumatorit dhe i ka konstatuar se KEK nuk ka vepruar sipas nenit 12 të procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, KEK-u prapë ka refuzuar ankesën e konsumatorit, duke mos e marrë për bazë shkeljen e procedurës.
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë sezonës dimërore me njehsor elektrik nr. 32807903 për periudhën 10/2007 – 03/2008 është 963.33 kWh/muaj, për periudhën 10/2006 – 03/2007 është 1058.33 kWh/muaj, ndërsa me njehsor elektrik nr. 4693004 për periudhën 10/2008 – 03/2009 është 867.00 kWh/muaj.  
**Provë:** Rrjedha e energjisë aktive
- ✓ Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë sezonës verore me njehsor elektrik nr. 32807903 për periudhën 04/2007 – 09/2007 është 480.33 kWh/muaj, ndërsa me njehsor

elektrik nr. 4693004 për periudhën 04/2009 – 09/2009 është 422.33 kWh/muaj.

**Provë:** Rrjedha e energjisë aktive

- ✓ Sipas këtyre analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike sipas sezonave vërehet se konsumatori ka një rënie të shpenzimit me njehsor të ri nr. 4963004, në krahasim me njehsorin e vjetër nr. 32807903
- ✓ Sipas rrjedhjes së energjisë aktive të konsumatorit shihet se konsumatori ka një rënie graduale të konsumit mesatar mujor nga viti në vit, dhe kjo ka vazhduar edhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik: 2004 – **1635** kWh/muaj; 2005 – **1070** kWh/muaj; 2006 – **1388** kWh/muaj; 2007 – **831** kWh/muaj; 2008 – **592** kWh/muaj; 2009 – **625** kWh/muaj. Pas vendosjes së njehsorit të ri (02.06.2008) konsumi mesatar mujor i konsumatorit është zvogëluar; 12 muaj para vendosjes së njehsorit të ri konsumi mesatar mujor ka qenë **729.75** kWh/muaj (regjistruar në njehsorin e vjetër), kurse 12 muaj pas vendosjes së njehsorit të ri konsumi mesatar mujor ka qenë **671.33** kWh/muaj (regjistruar në njehsorin e ri).  
**Provë:** Listat e rrjedhjes së energjisë aktive
- ✓ KEK-u nuk ka bërë asnjë analizë të konsumit të konsumatorit, por e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike vetëm duke u bazuar në konstatimet teknike të punëtorëve të qendrës së kalibrimit.
- ✓ Me datë 10.11.2008 komisioni i KEK-ut në rekomandimin e tyre për faturim të rikthimit të humbjeve nuk ka bërë asnjë analizë të lëndës së konsumatorit, por vetëm ka shënuar procesverbalet e KEK-ut.  
**Provë:** Rekomandimi i komisionit të KEK-ut për faturim të rikthimit të humbjeve e datës 10.11.2008
- ✓ Sipas deklaratës së konsumatorit theksohet se këtë veprimtari e ushtron me këtë biznes nga muaji korrik i vitit 2003 dhe se ka qenë me qera në atë objekt. Nga viti 2007 ka kaluar në objektin e ri të ndërtuar përball objektit të vjetër dhe se është bërë zhvendosja e njehsorit elektrik nga adresa e vjetër në adresë të re. Për këtë çështje ka qenë në dijeni dhe se e kanë bërë edhe bllobimin e njehsorit elektrik.  
**Provë:** Deklarata e konsumatorit

DMK duke u bazuar në analizat e cekura më lartë, ka rekomanduar Bordin e ZRRE-së që të **pranon** ankesën e konsumatorit dhe të vjen në përfundim se:

1. KEK-u duhet të shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR08HP06819 në vlerë prej 3,684.88 € e datës 14.11.2008.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura në rekomandimin e DMK dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Të shkarkojë konsumatorin nga ngarkesa e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike fatura DPR08HP06819 në vlerë prej 3,684.88 € e datës 14.11.2008.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimi të këtij Vendimi.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar